

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit Master i Shkencave në:
Gjuhë dhe Letërsi Angleze
Ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Leonard DANGLLI
Dr. Ergys BEZHANI



(Maj / 2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në: “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “ Bedër”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 330, datë 07.08.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 223, datë 04.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimit
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (shtatë)
16	Numri i studentëve në këtë program studimi	28

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Programi i studimit Master i shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, është hapur / licensuar me Urdhër të MASH Nr. 330 datë 07.08.2012, në përputhje me Vendimin Nr. 351 datë 13.07.2012 të Këshillit të Akreditimit. Ky program studimi është akredituar për herë të parë me Urdhër të MASH Nr. 223, datë 04.06.2013, duke i vendosur detyrim plotësimin e rekomandimeve të vendosura nga Këshilli i Akreditimit në vendimin Nr. 469, datë 03.05.2013.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Kolegjin Universitar “Bedër” është pjesë e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Në përputhje me ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër)”, të ndryshuar, si edhe akteve të tjera ligjore në fuqi në lidhje me arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze vepron si njësi bazë mësimore dhe kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e gjuhës dhe letërsisë angleze dhe mësimdhënies e gjuhës angleze si gjuhë e huaj.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Dr. Leonard Danglli
2. Dr. Ergys Bezhani

Gjate gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistet e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli dhe Znj. Aviola Bardhi.

Kolegji Universitar “Bedër” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.04.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 6/49 Prot, datë 30.04.2019. KU “Bedër” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 147/10 Prot, datë 06.05.2019 komente në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

Lidhur me komentin e parë, duhet theksuar se pohimi i bërë nga grupi i vlerësimit të jashtëm në raport se “studimi i nevojave të tregut të punës duhet bërë në mënyrë periodike për shkak të ndryshimeve të shpejta në këtë treg dhe nëse është e nevojshme të bëhet përshtatja e programit të studimit sipas nevojave të tregut dhe zhvillimit ekonomik të vendit.”, nuk nënkupton se nuk është realizuar studim tregu (evidenca 10), por thjesht thekson rëndësinë për nevojën e përgjithshme për analizë të vazhdueshme tregu në programin e studimit, ashtu si në të gjitha programet e studimit. Pra, konstatimi i bërë nga grupi i vlerësimit nuk nënkupton mungesën e këtij studimi, **GVJ i qëndron këtij rekomandimi.**

Lidhur me komentin e dytë, për të dy konstatimet e grupit të vlerësimit të jashtëm “të shihet me përparësi shtimi i numrit të studentëve dhe personelit akademik në programe shkëmbimi apo projekte

të ndryshme ndërkombëtare.” dhe “duhet të rritet më tej angazhimi për të përfshirë personelin akademik në programe shkëmbimi apo projekte ndërkombëtare, në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies.”, GVJ vazhdon t’i qëndrojë mendimit se ka gjithmonë hapësirë për rritjen e angazhimit konkret të studentëve dhe stafit akademik në programe apo projekte të ndryshme ndërkombëtare, pa nënkuptuar aspak se institucioni nuk ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi apo nuk është angazhuar në programe apo projekte të ndryshme. GVJ i qëndron këtij rekomandimi.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

Këshilli i akreditimit me Vendimin Nr. 469, datë 03.05.2013 vendosi akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” duke i vendosur detyrim plotësimin e rekomandimeve si më poshtë vijon:

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të rritet numri i personelit akademik të specializuar sipas fushave të veçanta duke u pasuruar me anëtarë që mbulojnë fushat specifike, e rëndësishme kjo për cilësinë në mësimdhënie.
- b) Të rritet numri i personelit akademik efektiv
- c) Të përputhet më shumë programi i punësimit me objektivat e tij të punësimit
- d) Të realizohet një ndërthurje tërësisht e balancuar midis lëndëve të formimit letrar dhe gjuhësor
- e) Të sigurohet që studentet e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Lidhur me rekomandimin a) “Të rritet numri i personelit akademik të specializuar sipas fushave të veçanta duke u pasuruar me anëtarë që mbulojnë fushat specifike, e rëndësishme kjo për cilësinë në mësimdhënie”, institucioni ka përmbushur rekomandimin duke rritur numrin e personelit akademik me kohë të plotë dhe të specializuar sipas fushave të veçanta. Në programin e studimit Master I Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze janë angazhuar pedagogë të huaj apo me përvojë ndërkombëtare në disa fusha apo lëndë të caktuara.
- b) Lidhur me rekomandimin b), “Të rritet numri i personelit akademik efektiv”, institucioni ka përmbushur rekomandimin duke rritur numrin e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”, duke arritur në vitin aktual 2018-2019, realizimin e këtij program studimi **90%** nga personel akademik efektiv.
- c) Lidhur me rekomandimin c), “Të përputhet më shumë programi i studimit me objektivat e tij të punësimit”, institucioni e ka konsideruar këtë rekomandim si pjesë të punës në vazhdim.
- d) Lidhur me rekomandimin d), “Të realizohet një ndërthurje tërësisht e balancuar midis lëndëve të formimit letrar dhe gjuhësor”, institucioni ka ruajtur natyrën kryesisht letrare të programit të studimit.
- e) Lidhur me rekomandimin e), “Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.”, ky

rekomandim është plotësuar pasi studentët kanë dhënë provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare përkatëse.

Institucioni i ka plotësuar në tërësi 5 rekomandimet e Këshillit të Akreditimit sipas VKA Nr. 469, datë 03.05.2013. Mbulimi pothuajse plotësisht i programit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze me personel akademik efektiv dhe angazhimi në këtë program i pedagogëve të specializuar në fusha të rëndësishme të tij ka një ndikim pozitiv në ecurinë dhe cilësinë e procesit mësimor. Gjithashtu, vlen të theksohet edhe angazhimi në këtë program studimi i personelit akademik me përvoja ndërkombëtare në mësimdhënien e fushave të caktuara të studimit. Ndërkohë, përshtatja e planit mësimor me objektivat e tij të punësimit apo vetë përbërja e tij janë një proces i vazhdueshëm.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në fushën e gjuhësisë angleze dhe letërsisë britanike e amerikane. Njëkohësisht, ky program studimi ka si objektiv edhe ndërthurjen e fushës së gjuhësisë dhe letërsisë me elemente kulturore apo të qytetërimit përkatës. Përfitimi i këtyre njohurive synohet të realizohet përmes metodave dhe strategjive që kanë në qendër studentin, duke i dhënë rol të rëndësishëm veprimtarive komunikuese, ndërvepruese apo të të menduarit kritik. Lëndët që ofrohen nga programi i studimit synojnë të përfshijnë një gamë të gjerë të elementeve që lidhen me gjuhën angleze moderne por edhe të parë nga këndvështrimi diakronik, si dhe etapave të ndryshme të letërsisë angleze dhe asaj amerikane. Programi i studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze përbëhet nga 120 ECTS dhe zhvillohet në dy vite akademike, në katër semestra. Në përfundim të semestrit të katërt, student duhet të dorëzojë dhe prezantojë përpara komisionit temën e masterit, të cilën ata e kanë punuar nën mbikëqyrjen e udhëheqësit shkencor.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezultoi se objektivat e këtij programi janë:

- Të formojë studiues të letërsisë për komunikim efektiv, në ligjërime të shkurtra në studime ndërsiplinore.
- Të pajisë studentët me njohuri mbi metodologjinë dhe teknologjinë e nevojshme bashkëkohore në mënyrë që të shfrytëzojnë të dhënat e hulumtimit tërësisht dhe me efikasitet.
- Të ndihmojë studentët të kuptojnë formimin intelektual dhe kulturor të kombit dhe letërsisë angleze dhe britanike, dhe t'i pajisë ata me konceptet dhe terminologjinë e përdorur në analizën e teksteve letrare.
- Të përgatisë studentë të përfitojnë nga burime të ndryshme të informacionit për të mundur dhe nxitur më tej zhvillimin e tyre profesional dhe personal në kontekstin e të nxënies afatgjatë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua një përputhje midis programit të studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, me qëllimin dhe misionin e institucionit.</p> <p>Rezultoni se është realizuar një studim tregu (evidenca nr. 10) për programin e studimit.</p> <p><i>Megjithatë, studimi i nevojave të tregut të punës duhet bërë në mënyrë periodike për shkak të ndryshimeve të shpejta në këtë treg dhe nëse është e nevojshme të bëhet përshtatja e programit të studimit sipas nevojave të tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit.</i></p> <p>Ky program studimi nuk cënon vlerat kulturore të kombit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Në objektivat e strategjisë afatgjatë KU “Bedër” ka si objektiv të zhvillojë, të përkrahë dhe të konsolidojë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe shërbime të tjera në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të aplikuar. Në këtë kuadër programi i studimit MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është përshtatur dhe ecën paralel me strategjinë për zhvillimin e KU “Bedër”.</p> <p>Strategjia për zhvillimin e institucionit merr në konsideratë vlerat universale të të nxënit të studentit, duke u mbështetur në përdorimin e qasjeve të ndryshme për kërkimin shkencor.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit u përgjigjet kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, gjykojmë se ato respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës dhe reflektojnë zhvillimet dhe kërkesat aktuale e perspektive të tregut të punës.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (Ligji Nr.10247, datë</p>

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Programet e studimit përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme për tu përshtatur me zhvillimet me të reja në këtë fushë, ato trajtohen në mënyrë kolegjiale dhe për të pasur një unifikim sa më të mirë.

Kolegji Universitar “Bedër” përpilon planin strategjik në nivel institucioni. Ky dokument shërben për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve. Në vijim të kësaj pune, Institucioni i jep një rëndësi të madhe procesit të të nxënit dhe mësimdhënies. Ndaj, për këtë çështje hartohet një plan strategjik në nivel institucioni.

Referuar takimit me stafin akademik të programit të studimit MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, institucioni synon të përmirësojë punën e tij, përmes aktivizimit të një stafi akademik të kualifikuar dhe punon për aplikimin e metodave bashkëkohore për ta bërë mësimdhënien sa më tërheqëse për studentët, duke synuar kështu një afrim të tyre më të madh drejt studimit me përmirësim të rezultateve të të nxënit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se Programi Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze:

1. Është hartuar në përputhje me misionin dhe vizionin e Kolegjit Universitar “Bedër”;
2. Ai zbatohet duke pasur parasysh dhe duke qenë në harmoni me strategjitë e institucionit si dhe planet strategjike të integritimit dhe zhvillimit ekonomik të vendit;
3. *Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, por sigurisht që ky studim duhet të bëhet në mënyrë periodike për shkak të ndryshimeve që mund të ndodhin në tregun e punës dhe nevojës së përshtatjes së programit të studimit me këto ndryshime.*

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësive, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Kolegji Universitar "Bedër" është i përbërë nga dy fakultete të cilët operojnë si njësi kryesore, dy qendra kërkimore zhvillimore, si edhe njësitë ndihmëse administrative, sipas organigramës së miratuar. Njësitë e lartpërmendura operojnë në bazë të parimit të autonomisë brenda kompetencave të tyre. Fakultetet janë respektivisht;

1. Fakulteti i Shkencave Humane;
2. **Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit.;**

Duke u bazuar në ligjin "Mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar me ligjin nr. 10307, datë 22.07.2010 "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, "Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë " Kolegji Universitar "Bedër" si dhe në ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", secili nga fakultetet përbëhet nga tre departamente.

Fakulteti i Shkencave Humane;

1. Departamenti i Drejtësisë
2. Departamenti i Shkencave të Komunikimit
3. Departamenti i Shkencave Islame

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit

1. **Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze**
2. Departamenti i shkencave të edukimit
3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit në vitin aktual **2018-2019** ka në përbërjen e tij **28** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **23** persona, nga të cilët **12** janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **5**, nga të cilët **4** me tituj/grada.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Dekani është autoriteti drejtues në fakultetin e Kolegjit, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij. Funkcionet dhe kompetencat e dekanit janë përcaktuar në nenin 12 të rregullores për organizimin akademik të KUB. Në lidhje me çështjet akademike, *Dekanati i Fakultetit* është organ kolegjal vendimmarrës, që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve, veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë të kërkimit shkencor të fakultetit.

Departamenti është njësi bazë mësimore kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Objekti i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Hapja, shkrirja ose mbyllja e departamenteve në KUB bëhet me propozim të Senatit dhe me miratim të Bordit të Administrimit.

Këshilli i departamentit kryesohet nga përgjegjësi i departamentit dhe përbëhet nga zëvendësit e tij, nëse ka, dhe nga anëtarët e stafit akademik të departamentit.

Përgjegjësi i departamentit drejton njësinë bazë duke u mbështetur në funksionet dhe kompetencat e parashikuara në statutin, rregulloren, apo aktet e tjera të institucionit, si dhe vepron në përputhje me

parashikimet e bëra në Ligjin 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, apo akte nënligjore në fuqi.

Ndër të tjera, përgjegjësi i departamentit drejton dhe kontrollon veprimtarinë pedagogjike dhe kërkimin shkencor të realizuar nga personeli akademik i njësisë bazë. Ai/ajo mbikëqyr procesin mësimor, realizimin dhe përmirësimin e kurrikulës dhe programeve të studimit të ofruara nga departamenti. Përgjegjësi i departamentit, për çdo semestër dhe vit akademik, evidenton nevojat për personel akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe ia përcjell këto nevoja dekanit të njësisë kryesore përkatëse dhe rektorit. Ai/ajo i propozon dekanit anëtarët e komisioneve të provimit të formimit apo edhe të mbrojtjes së diplomës për programet që ofrohen nga njësia bazë e drejtuar prej tij/saj.

Koordinatori i departamentit, i cili ka funksion ndihmës akademik me karakter administrativ, kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të realizimit të veprimtarisë së tij sipas përshkrimit të punës.

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit si njësi kryesore në Kolegjin Universitar “Bedër”, bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimdhënëse-kërkimore.

Njësitë bazë në përbërje të Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit janë:

1. Departamenti i Shkencave të Edukimit;
2. **Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze;**
3. Departamenti i Shkencave Kompjuterike.;

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, i cili është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, ka personel akademik me grada shkencore, kualifikimet e të cilit janë në përputhje me disiplinat që ofrohen nga programi i studimit në fjalë. Nga akreditimi i fundit i programit në vitin 2013 deri në vitin akademik 2018-2019, nuk kanë ndodhur ndryshime të tilla në stafin akademik të departamentit që mund të cenojnë zhvillimin apo mbarëvajtjen e programit të studimi.

Gjatë vitit akademik **2018-2019** departamenti ka në përbërje gjithsej **9 personel akademik** nga ku **8 personel akademik efektiv (PAE)**, nga ku **5 me gradën Dr**, dhe **1 personel akademik me kontrate (PAK), me gradën Dr**.

Në vitet e mëparshme akademike raportet PAE/PAK të departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze kanë qënë si më poshtë: **(sipas RVB)**

Për vitin akademik **2017-2018**, (7 / 2), nga këta me grada shkencore **4 / 1**;

Për vitin akademik **2016-2017**, (7 / 2) nga këta me grada shkencore **3 / 1**;

Për vitin akademik **2015-2016**, (8 / 5) nga këta me grada shkencore **4 / 2**;

Për vitin akademik **2014-2015**, (8 / 7) nga këta me grada shkencore **4 / 2**;

Për vitin akademik **2013-2014**, (11 / 12) nga këta me grada shkencore **5 / 4**;

Siç u vërtetua edhe nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore si dhe dokumenteve të tjera, angazhimi i personelit akademik në lëndë të ndryshme është bërë kryesisht në përputhje me profilin e tyre akademik.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Nga ana institucionale, KUB është i organizuar në dy Fakultete;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Humane; 2. Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit. <p>Secili prej tyre përfshin tre departamentye. Për mbarëvajtjen e punës së këtij Institucioni janë hartuar misioni dhe objektivat përkatëse për përmbushjen e tij. Secili Departament ka në përbërjen e tij së paku 7 anëtarë efektivë dhe 3 me gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, i cili është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, si njësi bazë, ka në përbërje të tij 8 pedagogë efektivë (PAE), ndër të cilët 5 janë me grada dhe tituj.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Përgjegjësitë e Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze si njësi bazë, si dhe të stafit të tij janë të përcaktuara qartë në aktet ligjore të institucionit. Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet</p> <p>Departamenti ka për detyrë të organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij.</p> <p>Në përputhje me nevojat për staf akademik Departamenti, paraqet kërkesat të cilat trajtohen sipas një procedure të mirëpërcaktuar e cila menaxhohet nga Zyra e Burimeve njerëzore</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimi i institucionit, përfshirë njësitë kryesore dhe ato bazë, janë në zbatim të kërkesave ligjore dhe në funksion të realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze. 2. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze plotëson kriteret si për personelin akademik në total, ashtu edhe për kërkesat në lidhje me kualifikimin e tij. 	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat;**

Personeli akademik i Departamentit kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit-shkencor dhe shërbime në përputhje me detyrat e përcaktuara dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës. Mësimdhënia ndër vite në këtë program studimi është mbuluar kryesisht nga pedagogë të brendshëm.

Të dhëna mbi numrin e stafit të angazhuar, ndër vite për këtë program studimi janë si më poshtë: **(sipas Dosjes së Vetëvlerësimit):**

Për vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 7 pedagogë gjithsej, nga të cilët 6 ishin personel akademik efektiv (PAE), dhe 1 personel akademik me kontratë (PAK). I gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është **85% PAE**.

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 5 pedagogë gjithsej, të gjithë personel akademik efektiv (PAE), dhe të pestë me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është **100% PAE**.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 5 pedagogë gjithsej, nga te cilet 4 ishin personel akademik efektiv (PAE), të gjithë me tituj/grada, dhe 1 personel akademik me kontratë (PAK), me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është **80% PAE dhe 20% PAK**.

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 8 pedagogë gjithsej, nga te cilet 6 ishin personel akademik efektiv (PAE), të gjithë me tituj/grada dhe 2 personel akademik me kontratë (PAK), me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është **75% PAE dhe 25% PAK**.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 3 pedagogë gjithsej dhe të gjithë ishin personel akademik efektiv (PAE). Të 3 pedagogët ishin me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është **100% PAE**.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte 7 pedagogë gjithsej, nga te cilet 5 ishin personel akademik efektiv (PAE), të gjithë me tituj/grada dhe 2 personel akademik me kontratë (PAK), me tituj/grada. Mbulimi i programit në përqindje është **72% PAE dhe 28% PAK**.

Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përgjithësisht zotëron kualifikime të ndryshme për specialitetin e lëndës që ofron, si dhe vijnë nga një përvojë e gjatë profesionale në fushën e mesimdhënies, ose në drejtimet profesionale që ata përfaqësojnë.

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program për vitin akademik aktual është **7 / 28**, (Studentët i perkasin ciklit të studimit dy viteve të fundit).

Raporti PAE/PAK në këtë program për vitin akademik aktual është **6 / 1**.

Bazuar në raportin e mësipërm, vihet re se ky program për vitin akademik aktual mbulohet **85 %** nga Personel akademik efektiv (PAE).

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Personeli akademik mësimdhënës ka tituj dhe grada shkencore dhe ky raport ka ardhur në rritje. Aktualisht ka **1 pedagog** me titullin shkencor “Profesor i Asociuar”, **6 pedagogë** me gradë shkencore “Doktor”.

Të dhënat sipas seksit

Për vitin akademik 2018 – 2019 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është **3/4**.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Personeli Akademik Efektiv përbëhet kryesisht nga personel i grupmoshës **36-45 vjecare**.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, konstatojmë se kontratat e punës që nënshkruhen në Kolegjin Universitar “Bedër”, lidhur me stafin akademik, janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Siç shihet edhe në evidencën nr. 18 (kontrata individuale e stafit akademik), kontrata e punës mbështetet në ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me arsimin e lartë jo publik në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë. Në 16 nenet e kontratës së punës, ndër të tjera, përshkruhen edhe të drejtat e detyrimet e punëdhënësit e punëmarrësit, mënyrat e zgjidhjes së kontratës, kohëzgjatja e kontratës, paga mujore, etj.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Pas vizitës në institucion konstatojmë se stafi ndihmës/administrativ i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit gëzon cilësinë e duhur për realizimin me sukses të këtij programi dhe nuk cenon mbarëvajtjen e tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
--------------------	-----------------------------



Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik dhe administrativ i institucionit është i përqendruar në përmbushjen e objektivave të programit të studimit, të cilët janë të harmonizuar dhe me strategjinë e institucionit.</p> <p>Performanca e mësimdhënies kontrollohet në mënyrë periodike në të gjitha aspektet duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Organizimi i programeve të studimit është një proces në të cilin përfshihen palët që kanë përvojën e duhur në KUB.</p> <p>Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njësisë bazë, departamentit. Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpara kolegëve ndryshimet e propozuara. Nëse vendimi miratohet në nivel departamenti, kalon për miratim në instancat më të larta të Këshillit të Fakultetit e më pas në Senatin Akademik.</p> <p>Njëkohësisht, këto palë janë të përfshira në rekrutimin e personelit të ri si edhe për ndarjen e ngarkesës mësimore. Gjatë kësaj ndarje merret në konsideratë legjislacioni në fuqi për këtë çështje.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Rekrutimi i personelit të ri bëhet në bazë të nevojave përkatëse për përmbushjen e nevojave të programeve të studimit. KUB ka një bazë të gjerë të dhënash për personelin e rekrutuar, mënyrën si janë bërë njoftimet për vendet vakante etj. Statuti dhe rregullorja përkatëse janë dokumentet e vetë Institucionit që merren si bazë për rekrutimin e tyre.</p> <p>Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit Msc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, gjatë periudhës 2013-2017 është mbuluar nga personel akademik efektiv (PAE).</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit përbën 85% të personelit akademik në total, 6 nga 7 personel gjithsej.</p>

	<p>Për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për rritjen e cilësisë së tij, ndiqen procedura ligjore për vlerësimin e personelit. Rezultatet e tij i bëhen me dije edhe personelit për të cilin është ndërmarrë pyetësori për një përmirësim të vazhdueshëm të tyre.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit, Dr. Lokman Coşkun, që është dhe përgjegjës i programit të studimit MSc në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” ka gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>KU “Bedër”, angazhon kryesisht si titullarë të lëndëve, moduleve personel akademik i cili minimalisht ka gradën shkencore Doktor.</p> <p>Drejtimesit e njësisë, Rektori, zv/Rektori, Dekani, Zv/Dekani, si dhe Përgjegjësi i Departamentit, janë të punësuar me kohë të plotë në KU “Bedër”.</p> <p>Ata përmbushin të gjithë nevojat e tyre duke ndihmuar gjithashtu edhe në përmbushjen e detyrimeve për udhëheqjen e temave të masterit.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore,</p>	<p>Për marrjen e diplomës përfundimtare studentët duhet të përgatisin një tezë. KUB organizon punë në mënyrë të tillë që secili student të ketë një udhëheqës shkencor me të paktën me gradën shkencore Doktor, i cili e orienton edhe për kërkimet përkatëse. Kjo gjë është e parashikuar edhe në rregulloren e studimit të ciklit të dytë të studimeve, neni 40.</p> <p>Për të shmangur mbingarkesën, një udhëheqës mund të marrë në udhëheqje deri në 10 studentë.</p>

<p>etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve për temën e diplomës garanton që udhëheqësi i propozuar të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar.</p> <p>Udhëheqësi zotëron të gjithë njohuritë e duhura, teorike dhe praktike, për fushën që do të orientojë studentin. Ai ka kualifikimet përkatëse dhe qasjet e duhura për lehtësimin e punës së studentit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Pas takimeve të ndërmarra në KUB u vu re që për përmbushjen e objektivave të MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, angazhohej dhe personel ndihmës në fushën e mësimdhënies dhe atë administrative.</p> <p>Detyrat e tyre janë të shprehura qartësisht dhe mbulojnë një gamë të gjerë duke filluar nga realizimi i oreve laboratorike e deri në mirëmbajtjen e tyre dhe të mjediseve të kolegjit.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ është i mendimit se ngarkesa mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe kontratës së lidhur me KUB.</p> <p>Personelit akademik i bëhet me dije që në fillim të vitit studimor ngarkesa që do të ketë. Kjo ngarkesë shprehet për të gjithë ciklet “me orë mësimore” duke bërë një unifikim të mënyrës së përlllogaritjes. Ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv caktohet në përputhje me udhëzimin e MASR lidhur me “veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”. Ngarkesa e caktuar për stafin akademik është e pranueshme.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në zyrën e burimeve njerëzore rezultoi se KUB ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik.</p> <p>KUB disponon një informacion të përditesuar për personelin akademik.</p> <p>Personeli që punon pranë KUB në MSc rekrutohet duke ndjekur procedura të rregullta dhe transparente. Në publikimin për një vend të lirë punë bëhen me dije kriteret që duhet të përmbushë kandidati. Për të gjithë personat e rekrutuar mbahet një doje e veçantë. Gjithashtu, KUB zotëron dhe listat përkatëse për secilin semestër ku janë të përfshirë të gjithë punonjësit që kanë ofruar shërbimet e tyre, në fushën akademike dhe atë administrative.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. 2. Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij dhe realizon ngarkesën në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. 3. Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit Msc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, gjatë periudhës 2013-2017 është mbuluar nga personel akademik efektiv (PAE). Në vitin akademik 2018-2019 personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit përbën 85% të personelit akademik në total, 6 nga 7 personel gjithsej. 4. Fusha studimore-kërkimore e udhëheqësit shkencor është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. 	

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion u verifikua se KUB vazhdon aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira për një periudhë dhjetëvjeçare, me sipërfaqe në total 5628 m². Gjatë vizitës në institucion u konstatua se kishte ambiente të përshtatshme për realizimin cilësor të këtij programi. Ambientet e sallave ishin të pajisura me kompjutera, aparate projeksioni etj. Ambientet e bibliotekës ishin të përshtatshme dhe kishte një fond të mjaftueshëm librash për programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset e Fakultetit përgjegjës për programin e studimit (sipas RVB)

Salla për leksione	4
Klasa për seminare	13
Salla për aktivitete promovuese	1
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	1
Laboratorë për lëndët	1
Laboratorë informatike	1
Salla internet	1
Salla për bibliotekë	1
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1
Zyrë informacioni për studentët	3
Nyje hidrosanitare	38

Gjatë vizitës në institucion konstatuam se mjediset në dispozicion të programit të studimit ishin të përshtatshme për realizimin me sukses të tij.

Mjediset për stafin (sipas RVB)

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 4
- Zyra për sekretarinë mësimore 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 6
- Zyra për personelin akademik 16
- Mjedise për stafin e shërbimit 2

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p>	
<p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p>	<p>Mjediset ku zhvillohen orët mësimore dhe ku ofron shërbimet e saj administrata janë në një vendndodhje të përhershme. Ajo është në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vite.</p>
<p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>Mjediset e brendshme (akademike, administrative, laboratorët, ato për realizimin e praktikave profesionale) janë të përshtatura dhe të menaxhuara në mënyrën e duhur për të gjithë shërbimet që ofrohen nga Institucioni.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p>Pasi vizitës që u bë në bibliotekën e KUB u vu re se aty gjendej një gamë e madhe literature e cila i vinte në ndihmë programit të studimit në fjalë. Oraret e shërbimit në bibliotekë janë në përputhje edhe me oraret e studimit dhe kërkesat specifike të studentëve. Mjediset e bibliotekës ishin të hapura gjatë gjithë kohës</p>
<p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Titujt e literaturave ishin të shumëllojshme dhe gjithashtu numri i librave. Tekstet mësimore, në bazë të kërkesave të përgjegjëseve të programeve, ishin të mjaftueshme dhe të viteve të fundit duke plotësuar kështu të gjithë nevojat e studentëve. Për të lehtësuar edhe punën e tyre, përveç botimeve periodike, në bibliotekë mundësohet shfrytëzimi i librarisë elektronike EBSCO Host, e cila siguron një numër shumë të larmishëm titujsh librash, revistash shkencore, e materiale të ndryshme mësimore të cilat i vijnë në ndihmë realizimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	
<p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>Zërat e bibliotekës në mbështetje të programit të studimit pasurohen në mënyrë të vazhdueshme, mbështetur në kërkesat e anëtarëve të personelit akademik të lëndëve përkatëse edhe ato përcillen për t'u mbështetur financiarisht në organin përkatës të institucionit.</p>
<p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Vizita në ambientet e institucionit dëshmoi se institucioni ofron një numër të mjaftueshëm laboratorësh, zyrash, klasash në proporcion me numrin e studentëve për program studimi.

Qëllimet e programit mbështeten nga një larmi pajisjesh mësimore të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit.

Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete të përshtatshme për realizimin e kërkesave të programit të studimit.

Në mbështetje të programit të studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze ekziston një laborator ku studentët zhvillojnë veprimtari të praktikës mësimore.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se:

1. Institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme, dhe të gjitha nevojat e tjera për realizimin e programit të studimit;
2. Institucioni ofron një numër të mjaftueshëm laboratorësh, zyrash, klasash në proporcion me numrin e studentëve për program studimi;
3. Biblioteka tradicionale dhe ajo elektronike sigurojnë një numër shumë të larmishëm librash, revistash shkencore, e materiale të ndryshme mësimore, të cilat i vijnë në ndihmë realizimit të programit të studimit.;

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar “Bedër” është institucion privat jofitimprurës. Pjesa më e madhe e të ardhurave të institucionit vijnë nga pagesat e studentëve dhe donacionet. KUB ka siguruar donacione nga institucione të ndryshme. Institucioni ka të drejtë të pranojë mbështetje financiare dhe materiale që lidhet me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Të hyrat dhe të dalat financiare të institucionit kontrollohen në mënyrë të rregullt nga institucionet kompetente shtetërore. Kostoja për student për vitin akademik 2017 -2018 sipas RVB ishte 153,619 LEKË.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim 1,312,193 (viti 2016)
- Konsulencat, shërbimet 376,050 (viti 2018-2019)
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit 28,011,220 (viti 2018-2019)
- Sponsorizimet nuk ka
- Shërbimet trainuese kualifikimi i vazhdueshë nuk ka
- Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj 1,224,600 (viti 2018-2019)
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, residencat, etj) nuk ka

Për të dhëna më të detajuara lidhur me të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi shiko Tabelën 6 në Aneks, e cila përfshin 6 vitet e fundit.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik

Shpenzimet për studentët për vitin akademik 2013-2014 ishin 177,066 ALL;

Shpenzimet për studentët për vitin akademik 2014-2015 ishin 210,543 LEKË;

Shpenzimet për studentët për vitin akademik 2015-2016 ishin 215,637 LEKË;

Shpenzimet për studentët për vitin akademik 2016-2017 ishin 165,449 LEKË;

Shpenzimet për studentët për vitin akademik 2017-2018 ishin 153,619 LEKË.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	KUB realizon audite të brendshme dhe të jashtme për vlerësimin e situatës financiare, dhe menaxhimi financiar është nën kontrollin e Fondacionit "Hafiz Ali Korca", pjesë e të cilit është Kolegji.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Gjatë shqyrtimit të RVB dhe vizitës në institucion u konstatua se institucioni ka një njësi auditimi të përvitshëm. Rezultatet e tij paraqiten në një raport vjetor financiar i cili përfshin mënyrën e përdorimit të buxhetit për një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e	

studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Pas vizitës në KUB dhe marrjes së dokumenteve përkatës, u vu re që për nevojat e tij Institucioni hartonte një raport financiar për të gjithë kostot e duhura për mbarëvajtjen e punës, ku përfshihen zërat e të ardhurave duke specifikuar burimet që vijnë nga pagesat që bëjnë studentët si tarifë studimi, donacionet nga brenda dhe jashtë vendit nga konsulenca të ndryshme etj.</p> <p>Pas shqyrtimit të veprimtarisë së deritanishme, rezultoi se KUB dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezultoi se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ka një raport financiar të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët nga donacione apo shoqata. Të ardhurat financiare dhe tarifat që paguanin studentët ishin lehtësisht të gjindshme për të gjithë periudhën që ka ushtruar veprimtarinë institucioni; 2. Çdo vit, KUB bën një auditim të jashtëm për sa i përket situatës financiare; 3. Të ardhurat financiare ishin të qëndrueshme duke siguruar kështu të ardhmen financiare të institucionit; 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion u konstatua se KU Bedër, ka një sistem funksional për sigurimin e brendshëm të cilësisë në rang institucioni. Funksionon komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë që përcakton strategjitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe vlerësimit të performancës akademike të personelit.

Sipas shqyrtimit të RVB disa nga Kompetencat e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë:

- Të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik.
 - Të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale të për të hartuar standardet për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë.
 - Të vlerësojë, në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet.
 - Të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji, në bashkëpunim me njësitë përkatëse.
 - Të ndjekë procesin e vlerësimit të brendshëm të institucionit, si dhe mbikëqyrjen e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit.
 - Të ndjekë përgatitjen e terrenit për “vlerësimin e jashtëm” të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe vënien në dispozicion të institucionit ose organizatës së vlerësimit të jashtëm të çdo informacioni të nevojshëm.
 - Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në bashkëpunim me sekretarinë mësimore.
 - Pas çdo vlerësimi raporton para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.
- Në janar të vitit 2010, KUB është pajisur me certifikatën ISO 9001:2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Për të mbikëqyrur zbatimin korrekt të të gjitha proceseve dhe procedurave të punës të parashikuara sipas standardit ISO, në KUB çdo vit është ngritur Grupi i Auditit të Brendshëm Ad-hoc, i cili nëpërmjet kryerjes së auditimeve periodike siguron zbatimin e proceseve dhe procedurave në fjalë në institucion.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

o Sa anketime kanë bërë me studentët

Anketime me studentë bazuar në rregulloren e vlerësimeve të njësisë bëhen në cdo fund semestri për të gjitha lëndët dhe me të gjithë studentët. Ato bëhen on-line dhe anonime.

o Sa studentë janë anketuar

Nga takimi me studentët e këtij programi rezultoi që janë anketuar të gjithë studentët sipas grupeve.

o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Përpunohen të gjithë pyetësorët.

o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Gjetjet dhe rekomandimet që rezultojnë nga vetvlerësimi i njësive bazë në KUB, përmbledhen në një raport që i paraqitet rektoratit. Gjate takimit me përfaqësues te NJSBC, u informuam për aplikimin e një formati tjetër për përmisimin e punëve në njësinë kryesore/bazë, që ishte organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të vetvlerësimit të përgatitura nga ato. Në këto analiza ishin prezent të gjithë anëtarët e personelit akademik e administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sygjerimet e tyre për përmisimin e ceshtjeve qe nevojite.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

KUB ka një komision të përhershëm për sigurimin e cilësisë, i cili përcakton edhe strategjinë dhe procedurat që ndiqen për sigurimin e cilësisë. Ka rregullore për aspekte të caktuara të sigurimit të cilësisë si rregullorja për organizimin administrativ, rregullorja e anketave dhe vlerësimit etj. NJSBC ka rregullore e cila rregullon organizimin dhe administrimin e njësisë për vlerësimin periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Nga vizita në institucion u konstatua se Departamenti bën një analizë pune për procesin mësimor. Pas kësaj analize hartohet një raport që i paraqitet Senatit. Kishte një formular vlerësimi për pedagogët në kuadër të rritjes së kualifikimit të tyre. Organizoheshin anketimet me studentët dy herë në vit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se institucioni ka një sistem për vlerësimin e programeve dhe përdor një sërë instrumentesh vlerësimi. Anketimi ishte njëri prej më të përdorurit pre tyre. Për të rritur cilësinë Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që ndërmerr për përmbushjen e kriterëve të cilësisë.</p> <p>U konstatua se institucioni ka një sistem informimi për publikimin e treguesve lidhur me procesin mësimor dhe i publikon rezultatet e vlerësimit të elementëve të ndryshëm brenda institucionit në faqen e tij zyrtare të internetit.</p> <p>Duke u bazuar në shqyrtimin e RVB dhe vizitës në institucion, u konstatua se institucioni përdor metoda të tërthorta edhe të drejtpërdrejta për vlerësim, kjo gjë është e sanksionuar edhe në rregullore të vecanta që monitorojnë këtë proces.</p> <p><u>Metodat e tërthorta janë fokusuar në:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës. Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga KUB Pyetje konceptuale Rekomandime nga studentët <p><u>Metodat e drejtpërdrejta</u> janë ato të përfshira edhe në programin e lëndës si:</p>

<p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>a) Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor;</p> <p>b) Vlerësime me notë dhe me pikë;</p> <p>c) Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët;</p> <p>d) Vlerësim për përfshirjen në aktivitete jashtë shkollore;</p> <p>e) Vlerësimi i studentëve më të mirë duke ju ofruar; Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës</p>
---	---

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Vlerësimi i brendshëm është një proces transparent që ndërmerret nga KUB dhe kjo ilustron me faktin e botimeve të ndryshme ku pasqyrohen rezultatet e tij

KUB, në përfundim të çdo viti akademik, publikon në faqen zyrtare të tij, raportin vjetor të veprimtarisë mesimore dhe kërkimore – shkencore, duke përfshirë edhe analizën SWOT.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Për mbarëvajtjen e ecurisë në MSc Gjuhë dhe Letërsi Angleze Institucioni ndërmerr analiza vjetore të rregullta të cilat më pas shoqërohen me hapa konkretë për përmirësimin e cilësisë së programeve.

KUB përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; nëpërmjet NjsBC. Rektorati kontrollon procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të tjera që universiteti kryen

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të

studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Institucioni ka ndërmarrë procedurat e akreditimit institucional dhe bazuar në Vendim e Bordit të Akreditimi Nr. 101, dt. 10/11/2017 institucioni është akredituar për një kohëzgjatje 4 vjeçare me afat vlefshmërie deri më datë 09.11.2021. Gjatë vizitës u arrit në përfundimin që institucioni përdorte një tërësi instrumentash dhe njësisish për sigurimin e cilësisë. Të gjitha këto vepronin mbi rregulloret për sigurimin e cilësisë.

Bashkëpunimi ndërmjet njësive institucionale është i ngushtë dhe ndihmon për zhvillimin e strategjive dhe planeve vlerësuese për personelin akademik. Në fund të çdo viti akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të stafit akademik.

Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore përcillen nga Departamenti në Senat, duke pasur parasysh parimin hierarkik vertikal: departament - fakultet - rektorat. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së zhvillimit të kurrikulave, e cila funksionon në bazë të një rregulloreje të veçantë.

Si stafit akademik dhe studentëve u janë vënë në dispozicion Manuali i Sigurimit të Cilësisë, si edhe Guida e Studentëve dhe ajo e stafit, ku shpjegohet rëndësia e cilësisë dhe siguri i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Këto dy dokumente janë publikuar në faqen e internetit të institucionit.

Institucioni ka të hartuar një strategji për periudhën 2018-2023, e cila jep mundësi për një vazhdimësi në procesin e sigurimit të cilësisë. Për të qenë sa më transparentë i gjithë informacioni është lehtësisht i gjendshëm përmes publikimeve të ndryshme.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se:

1. Në bazë të rregullores dhe të statutit është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve;
2. Vlerësimi i pedagogëve bëhet përmes anketimeve të studentëve, vetëvlerësimit dhe vlerësimit të eprorit brenda njësisë. Ky vlerësim është periodik dhe njëkohësisht ndërmerren mekanizma formalë për mbikëqyrjen e programeve që ofron;

3. Përmirësimi i cilësisë është një ndër prioritetet kryesore të institucionit;

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, i ofruar nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, është një program studimi i ciklit të dytë, i organizuar në dy vite akademike, me një numër total kreditesh prej 120 ECTS. Një vit akademik, i cili përmban 60 ECTS, është i ndarë në dy semestra.

Në këtë program studimi, gjuha angleze është gjuhë e detyrueshme e programit. Realizohet një trajtim i thelluar i çështjeve që lidhen me zhvillimi historik të gjuhës dhe letërsisë, marrëdhëniet midis gjuhës dhe të menduarit si dhe marrëdhëniet midis gjuhës dhe kulturës. Ashtu si edhe në programin e studimit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, programi i studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze ka si qëllim ndërthurjen e aspekteve teorike të të nxënit me aplikimin praktik të tyre. Gjithashtu, synohet ndërthurja dhe zhvillimi i katër shprehive bazë të gjuhës, ku përfshihen të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit. Këto katër shprehi bazë ndërthuren me një gamë të gjerë elementesh kulturore, letratë etj., të cilat synojnë të zhvillojë edhe aftësitë e ndryshme të komunikimit dhe mendimit kritik. Ky program studimi përfshin një projekt dhe një punim shkencor, i cili realizohet në përfundim të programit të studimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, është hapur / licensuar me Urdhër të MASH Nr. 330 datë 07.08.2012. në përputhje me Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 351 datë 13.07.2012. Ky program studimi është akredituar për herë të parë me Urdhër të MASH Nr. 223, datë 04.06.2013 "Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit". Qëllimi kryesor i programit Master i shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është përgatitja e profesionistëve me njohuri të thelluara në fushën e gjuhës dhe letërsisë angleze, si dhe zhvillimin e shprehive të tilla si të menduarit kritik, komunikimit ndërveprues dhe aftësive të tjera që lidhen me fushën e gjuhësisë dhe letërsisë. Viti i fillimit për këtë program studimi ka qenë viti akademik 2013-2014.

Organizimi i programit të studimit

- Programi i studimit përbëhet nga **2 vite akademike;**
- Një vit akademik përbëhet nga **2 semestra;**
- Një vit akademik ka **32 javë mësimore;**
- Një semestër ka **16 javë mësimore në auditor;**
- 1 ECTS është llogaritur **25 orë pune e studentit** në auditor dhe punë individuale;
- Programi i studimit Master i shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze ka një sasi totale prej **120 ECTS**, ku një vit akademik përmban 60 ECTS, ndërsa një semestër përmban 30 ECTS.
- 1 orë mësimore zgjat **60 minuta**, ndërkohë në vitin akademik 2018-2019 një orë mësimore zgjat 50 minuta (në zbatim të udhëzimit të MASR).

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, bazuar në planin mësimor të propozuar nga departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me vendim të Këshillit të fakultetit dhe miratuar me vendim senati. Plani mësimor që ofron ky program studimi është në favor të thellimit të njohurive dhe shprehive për studentët e ciklit të dytë.

Për të dhëna të hollësishme lidhur me planin mësimor sipas viteve akademike shih **Tabelën 8** në Aneks.

Ndarja e orëve në auditor për leksionet, seminarët praktikat lëndore dhe provimin përfundimtar , si dhe orët e pavarura të studentit janë si më poshtë:

- Për leksionet 832 orë në auditor dhe 871 orë punë e pavarur e studentit;
- Për Seminarët 80 orë në auditor dhe 277 orë punë e pavarur e studentit;
- Për Laboratorët 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit;
- Për Praktikët lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit;
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 370 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara:

Ka ndodhur vetëm një ndryshim në planin mësimor, konkretisht në kodin e lëndës pa prekur asnjë element tjetër të planit. Nga *ELL 430 "Letërsia dhe Kultura Mesjetare"* u ndryshua në *ELL 433 "Letërsia dhe Kultura Mesjetare"*.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në ASCAL, duke iu referuar tre viteve të fundit të këtij programi, si dhe pedagogët të cilët mbulojnë këto lëndë në planin mësimor rezultojnë se: plani mësimor mbulohet nga pedagogë të brendshëm sipas viteve në masën:

Për vitin akademik 2016-2017 në masën **85 %**, (4 PAE / 1PAK);

Për vitin 2017-2018 në masën **100 %**, (5 PAE / 0 PAK);

Për vitin 2018-2019 në masën **85 %**, (6 PAE / IPAK);

Pedagogët kanë nivelin e kërkuar të kualifikimit shkencor, për vitet 2016-2017, 2017-2018 dhe 2018 - 2019 të gjithë pedagogët janë me tituj/grada. Nga njëri vit akademik në tjetrin shikohet një qëndrueshmëri e stafit akademik që angazhohet në këtë program studimi.

Për të dhëna më të hollësishme lidhur me planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës shih **Tabelën 10 në Aneks.**

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga shqyrtimi i syllabuseve rezultoi se përmbajtja e syllabuseve ishte e standardizuar duke reflektuar prezantimin e të dhënave kryesore mbi lëndën. Syllabuset përmbanin elementët e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Pas analizës së silabuseve (evidenca 37), u vu re se ata përmbajnë elementet e nevojshëm, përfshirë objektivat e lëndës, rezultatet e pritshme, temat sipas javëve, literaturën, mënyrën e vlerësimit, ngarkesën ECTS, etj. Silabuset janë organizuar sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, duke përfshirë elementet kryesore që parashikohen në këtë vendim. Duhet theksuar gjithashtu se silabusi është i aksesueshëm online në faqen zyrtare të programit të studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është akredituar fillimisht në vitin 2013. Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit përkatës arrihet në përfundimin se studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë	Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Dytë të Studimeve dhe plani mësimor i programit të studimit parashikon

është 60 kredite;

sasinë mesatare të krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek programin “Master në Gjuhë dhe Letërsi Angleze” me kohë të plotë është 60 kredite.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e

Pasi studentët kanë përfituar njohuritë e përgjithshme në nivelin Bachelor, në Programin e studimit “Master i Shkencave”, ata përfirojnë njohuri më të thella teorike dhe praktike. Njëkohësisht ata përfitojnë njohuri edhe në fushën e kërkimit shkencor dhe trajnime profesionale.

Zbatimi i parimeve dhe metodave shkencore bazë është në qendër të studimeve të ciklit Master. Ato përdoren për të përftuar njohuritë bazë dhe zgjerimin e tyre.

Programi i studimit MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze fuqizon studentët në përftimin e shprehive të nevojshme për një gamë të gjerë profesionale, në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Për ata studentë që përfundojnë studimet me rezultate të kënaqshme, është i mundur dhe kalimi me sukses i programit të doktoraturës në këtë fushë. Studentët përballen dhe ushtrojnë një sërë shprehish të cilat janë në linjë me profesione të ndryshme ku ata synojnë të përfshihen.

tregut të punës.	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” nëpërmjet moduleve të lëndëve synon zgjerimin dhe thellimin e njohurive teorike, praktike dhe profesionale të studentëve si dhe njohjen e tyre me procesin e kërkimit shkencor. Modulet/lëndët e këtij programi ndërtohen mbi njohuri të fituara në ciklin e parë të studimeve dhe gjatë këtij cikli studimi studentët krijojnë baza të forta për të vazhduar studimet në ciklin e tretë.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve përkatëse. Studentët vlerësohen edhe nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive gjatë vitit akademik, duke mundësuar një vlerësim sa më objektiv për arritjet dhe nivelin e tyre të dijeve konform programit të studimit.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga takimi me pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi, rezulton se ky program është hartuar duke u mbështetur në kurikulat e universiteteve me përvojë të gjatë në këtë fushë duke i përshtatur ato me tregun e punës në Shqipëri.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve u konstatua se ky program është ndërkombëtarisht konkurrues si nga ana teknike, ashtu edhe nga ana e përmbajtjes.</p> <p>KUB në tërësinë e tij është ndërtuar në mënyrë të tillë që t’i përgjigjet kërkesave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo vihet re nga prania e studentëve të huaj në KUB si edhe nga punësimi që kanë gjetur studentët e mëparshëm të këtij Institucioni. Vetë programet janë hartuar bazuar në përvojat dhe sistemin e vlerësimit ndërkombëtar.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve arrihet përmes kurrikulës që kombinon teorinë me aplikimin, me punësimin në procesin e mësimdhënies, të stafit me përvojë profesionale. MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze mbështetet në programe mësimore ku, ndër të tjera, studentët aftësohen nga ana profesionale dhe mbështesin kërkimin shkencor.</p>

<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e KUB.</p> <p>Stafi akademik ka njohuritë dhe përvojën e duhur për t'i mbështetur studentët në këto dy fusha.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N / A</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Studimi i tregut i ndërmarrë nga KUB nxjerr në pah se programi i studimit MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është në harmoni me nevojat e tregut të punës, të cilat mbështeten në synimet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit.</p> <p>Studimi i tregut të punës, i kryer nga institucioni në vitin 2017, mbulon çështjet që lidhen me mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e tregut, një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet e ngjashme.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>KUB ofron programe studimi që janë në mbështetje të interesave kombëtare për një arsimim cilësor, me objektiv formimin e një brezi të ri intelektualësh.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian. Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera</p>

	nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi MSc në Gjuhë dhe Letërsi organizohet në module dhe vlerësohet në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Siç parashikohet edhe në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Dytë të Studimeve dhe në planin mësimor të programit të studimit, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek programin "Masteri i Shkencave" në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është 60 kredite ndërsa i gjithë programi i studimit (2 vite akademike) përfshin gjithsej 120 kredite. Në përfundim të studimeve realizohet edhe tema e masterit, e cila prezantohet përpara një komisioni vlerësimi.
Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	N / A
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	N / A
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Syllabuset e të gjitha lëndëve u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik. Përmes tyre ata njihen me orët në auditor, ndarjen në leksione, seminare, laboratorë dhe praktika, detyrimet që lidhen me frekuentimin dhe detyrime të tjera që lidhen me shlyerjen e lëndës sipas programit përkatës. Për të lehtësuar komunikimin ndërmjet studentëve dhe vetë institucionit, KUB përdor mekanizma të ndryshëm
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	

	për ndarjen e informacionit duke filluar nga materiale të shkruara deri te ato elektronike. Vlen për t'u theksuar përdorimi i sistemit informativ në Bedër (BIS).
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	Për të pasur një organizim sa më të qartë të hapave që duhet të ndjekë studentë për të marrë diplomën përkatëse KUB ka hartuar një plan diplomimi. Në këtë plan janë përcaktuar qartësisht afatet kohore dhe numrin e krediteve për hartimin e projektit kërkimor dhe tezës përfundimtare, ku kësaj të fundit i janë dhënë 30 ECTS.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe merr parasysh nevojat e tregut të punës. 2. Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze, duke përgatitur në këtë mënyrë specialistë të aftë për tregun e punësimit; 3. Studentët disponojnë gjithë informacionin për programin e studimit. Çdo fillim semestri atyre u vihen në dispozicion kalendari dhe llojet e lëndëve që do të zhvillohen; 4. Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programin e studimit është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu, programi i studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30 kredite europiane ECTS për tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtij programi. 	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze zhvillohet duke zbatuar një sërë qasjesh dhe veprimtarish dhe duke u bazuar te metoda të shumëllojshme metodash dhe strategjish të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Objektivat dhe rezultatet e pritshme për çdo lëndë jepen në silabusin e çdo lënde, me të cilin studentët njihen që në fillim të semestrit dhe mund ta shikojnë atë online.

Gjithashtu, rregullorja e Studimeve të Ciklit Dytë dhe e provimeve shpjegon çështje që lidhen me organizimin e mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesën dhe cilësinë e realizimit, kontrollin e njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies, aktivizimin e studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, etj.

Për angazhimin e pedagogëve në procesin mësimor dhe teknikat që ata përdorin për procesin e mësimdhënies merren vlerësime nga studentët gjatë anketave që ata zhvillojnë dy herë brenda vitit akademik. Mendimet dhe propozimet e studentëve vlerësohen nga departamenti në favor të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjithashtu, për garantimin e standardeve shtetërore nga ana e stafit akademik, burimet njerëzore dhe NJSBC-ja, organizojnë trajnime dhe workshop-e .

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Për një student në programin Msc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze pjesën më të madhe e zënë orët në auditor për leksione dhe seminare. Orët në total për format e mësimdhënies për këtë program sipas RVB janë:

• Leksione	832 orë
• Seminare	80 orë
• Ushtrime	0 orë
• Laboratore	0 orë
• Detyre	0 orë
• Praktikë lëndore	0 orë
• Praktikë profesionale	0 orë
• Etj	370 orë
• Totali	1282 orë në auditor

Format kryesore të mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze janë leksionet dhe seminarat. Sic parashikohet edhe Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë (evidenca nr. 36), veprimtari të tjera në ciklin e dytë të studimeve janë “projektet dhe puna në studio, punimet në laborator praktikat, seminare, punimi i diplomimit dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor, si dhe cdo element tjetër të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për elementet që duhet të përmbajnë programet e studimit”. Kohëzgjatja normale e lëndëve në programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është një semestër, ndërsa gjuha e programit të studimit është gjuha angleze.

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive të studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze përfshijnë disa elemente si provimet, pjesëmarrja në klasë, detyrat apo projektet etj. Lëndët përfshijnë dy provime, atë të ndërmjetëm, i cili zhvillohet në mes të semestrit dhe provimin përfundimtar, i cili zhvillohet në fund të semestrit. Format e kontrollit të njohurive dhe mënyra e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë jepen në silabusin përkatës, me të cilin studentët njihen që ditën e parë të zhvillimit të lëndës. Ndërkohë, tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës sipas një formati të përcaktuar nga institucioni.

Për një pasqyrë të qartë të formave të kontrollit të njohurive, **shih Tabelën 12 në Aneks.**

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Katër janë format e angazhimit të studentëve në aktivitetet e departamentit dhe të fakultetit:

për punime shkencore individuale të pedagogëve;

për projekte shkencore në rang departamenti;

për projekte shkencore në rang fakulteti;

për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë;

Konstatuam se krahas procesit mësimor, programi aktivizon studentët në aktivitete të ndryshme të njësisë me karakter kërkimor si dhe seminare e leksione të hapura. Një ndër këto veprimtari është edhe konferenca e organizuar çdo vit nga departamenti ICELL. Një listë e veprimtarive vjetore të programit si pjesë e njësisë kryesore pasqyrohet në raportin vjetor të departamentit. Studentët merrnin pjesë në punimet shkencore individuale të pedagogëve janë 6 studentë, në projekte shkencore të departamentit janë 20 studentë, në projekte shkencore në rang fakulteti janë 10 studentë, ndërsa në projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë janë 6 studentë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve për programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, dhe në kriteret specifike që ka KUB. Për të realizuar sa më mirë procesin e regjistrimit të studentëve, në Kolegjin Universitar Bedër funksionon zyra e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, e cila merret në mënyrë specifike me çështjet e pranimit të studentëve të rinj në programet e studimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe gjatë vizitës në institucion u informuam se çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Përveç kësaj sekretaria mësimore, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme. Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KUB përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale. Në këtë funksion, pranë KUB shërben edhe zyra e protokollit dhe korrespondencës. Ndërkohë, studentët e regjistruar informohen përmes sistemit BIS (Sistemi Informativ Bedër), në të cilin studentët informohen për një shumëllojshmëri përbërësish të procesit mësimor. Udhëzuesi i Sistemit Informativ jep me hollësi funksionimin e këtij sistemi informativ. U informuam gjithashtu se për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KUB ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë drejtorisë së marrëdhënieve me studentët. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake, kërkon mundësitë e punësimit për të gjithë studentët e diplomuar në programet “Bachelor” dhe “Master”, organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit, etj.”

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Për t'u pranuar në programin e studimeve "Master i shkencave" në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, çdo shtetas shqiptar apo i huaj që aplikon nevojitet të ketë përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit *Bachelor*. Preferohen ata studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit *Bachelor* në programin e studimit të gjuhë dhe letërsisë angleze ose programe të ngjashëm.

Pranohen për t'u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" ose "Master profesional" shtetasit shqiptarë që plotësojnë këto kushte:

1. Mesatarja e studimeve të ciklit të parë, në masën 70%.
2. Intervista nga komiteti shkencor i departamentit përkatës, në masën 30%.
3. Përshtatmëria e programit të studimit pararendës me atë për të cilin aplikon, sipas përcaktimit të bërë në rregulloret specifike të programeve të ciklit të dytë.
4. Plotësimi i kushtit të mbrojtjes së një prej pesë gjuhëve të huaja në nivelin B1, sipas përcaktimit në udhëzimin nr.52, datë 3.12.2015.

Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në rastet kur studentët janë të huaj ose kanë mbaruar studimet jashtë Shqipërisë atyre ju kërkohet që të plotësojnë këto kushte:

1. vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e studimeve të ciklit të parë me diplomë "Bachelor" në Shqipëri ose jashtë shtetit (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës);
2. plotësojnë kushtet e tjera të pranimit të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të KUB-it;
3. pranojnë pagimin e tarifës së caktuar mujore ose vjetore

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Vihet re një vazhdimësi në cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje. Bazuar në treguesit e nivelit të studentëve që vijnë të ndjekin këtë program u konstatua se kontigjenti më i madh është midis mesatares "mirë" dhe "shumë mirë".

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare:

Studentë të regjistruar për herë të parë për ciklin e studimit (2017-2018, dhe 2018-2019) janë gjithsej 28, me një notë mesatare 2.80 sipas sistemit amerikan.

Për të dhëna të hollësishme lidhur me studentët, **shih Tabelat 13 dhe 14 në Aneks.**

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Studentë të diplomuar në vitin e fundit pa vite përsëritëse janë 9 studentë, me notë mesatare 3.52, sipas sistemit amerikan të brendshëm të sistemit të vlerësimit.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion rezulton se KU Bedër ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me Universitete të huaja, të cilat synojnë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. Për këtë program studimi është angazhuar 1 student. *Megjithatë, duhet të shihet me*

përparësi shtimi i numrit të studentëve dhe personelit akademik në programe shkëmbimi apo projekte të ndryshme ndërkombëtare.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Studentët që mbarojnë programin Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze mund të punësohen në pozicione që kërkojnë njohuri të mira të gjuhës angleze. Rezulton se nga 20 të diplomuar, 17 prej tyre janë punësuar në përputhje me diplomën, ndërsa për 3 prej tyre mungon informacioni.

Numri total të diplomuarve

Janë 20 studentë të diplomuar.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Janë 17 studentë të punësuar në përputhje me diplomën.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Për 3 të diplomuar nuk ka informacion.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në</p>	<p>Për të ndjekur studimet në KUB duhet të ndiqen disa hapa për pranimin e studentëve.</p> <p>Regjistrimi i studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze bëhet pasi ai ka përfunduar nivelin Bachelor, të ketë marrë 180 kredite sipas sistemit ECTS dhe të ketë plotësuar kriteret e pranimit.</p> <p>Njëri prej kriterëve në Programin Msc Gjuhë dhe Letërsi Angleze është mbrojtja e gjuhës angleze sipas provimeve të njohura në nivelin ndërkombëtar.</p> <p>Për t’u pranuar në programin e studimit në fjalë, studenti duhet të ketë njohuri të gjuhës angleze sipas nivelit të kërkuar nga udhëzimi përkatës i MASR.</p> <p>Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.</p>

<p>përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Informacioni për mundësitë për punësim pas diplomimit, në përfundim të këtij programi, u jepet studentëve në forma të ndryshme.</p> <p>Për të pasur një orientim sa më të saktë të studentëve mbi të ardhmen e tyre pas përfundimit të studimeve në MSc Gjuhë dhe Letërsi Angleze, atyre u ofrohet këshillimi i karrierës. Gjatë këtij këshillimi, por edhe gjatë takimeve të ndryshme që mund të bëhen mes tyre dhe zyrave të ndryshme, atyre u bëhet me dije se cilat janë mundësitë e punësimit në të ardhmen. Gjithashtu ata njoftohen edhe për proceset e akreditimit të institucionit dhe të programeve, si edhe njohjen e tyre nga institucione ne nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Në programin MSc Gjuhë dhe Letërsi Angleze, KUB ka të dhëna të detajuara për secilin student që prej regjistrimit të tij për herë të parë deri në marrjen e diplomës përkatëse. Kjo rregullshmëri u konstatua edhe gjatë vizitës që u bë pranë sekretarisë mesimore. Secili student kishte dosjen e tij ku gjendej i gjithë informacioni i nevojshëm.</p> <p>Në statistikat vjetore KUB disponon informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar në ciklin e dytë, tërheqjen nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Institucioni ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p>	<p>Përveç studentëve që janë duke ndjekur aktualisht studimet në nivelin Master, KUB disponon informacion edhe për studentët që tashmë i kanë përfunduar studimet e tyre. Aty përfshihet edhe pozicioni i punës në mënyrë që këtë informacion ta</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>ndajnë edhe me studentët aktualë që ata të krijojnë një ide më të qartë për të ardhmen e tyre.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p>	<p>Studentët e programit të studimit MSc në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” nëpërmejt Sekretarisë mësimore, pedagogëve të lëndëve dhe Departamentit informohen në lidhje me programet e studimeve të zgjedhur prej tyre, afatin e përfundimit të programit, mënyrën e organizimit të programit të lëndëve përkatëse si dhe statusin e akreditimit të programeve.</p>
<p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p>	<p>Informacioni që ndahet me studentët është i vazhdueshëm, konkret dhe i hollësishëm. Ata përditësohen mbi rezultatet e vlerësimit deri në përfundimin e të gjithë procesit. Pas çdo provimi publikohen rezultatet paraprake për çdo student. Studentëve u lihet një afat për ankimimet e mundshme lidhur me rezultatet e provimit</p>
<p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Për transparencë është vetë drejtuesi i modulit që informon publikisht rezultatet e vlerësimeve.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p>	<p>Personeli i KUB është i trajnuar për t'i ardhur në ndihmë studentëve lidhur me problematika të ndryshme që ata mund të hasin gjatë procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Për të qenë sa më produktiv ata gjithashtu ndjekin edhe ecurinë e tyre akademike si edhe japin orientimet përkatëse mbi përzgjedhjen e institucionit ku mund të zhvillojnë veprimtari praktike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezultojnë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët që pranohen në programin Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, zotërojnë së paku një diplomë të nivelit Bachelor dhe kanë përmbushur kriterin e 180 krediteve ECTS në ciklin e parë të studimeve; 2. Kriteret dhe procedurat e regjistrimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi; 3. Nga ana GJV u evidentua se Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Sekretarinë Mësimore disponon të gjitha statistikave të nevojshme për këtë program studimi; 4. Institucioni informon studentët në lidhje me statusin e institucionit, të programeve të 	

studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit;

5. KUB disponon statistika vjetore për numrin etë diplomuarve në programin e studimit që kanë përfunduar dhe mban të dhëna me punësimet e studentëve të diplomuar.
6. *Të shihet me përparësi shtimi i numrit të studentëve dhe personelit akademik në programe shkëmbimi apo projekte të ndryshme ndërkombëtare.*

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor **Pjesa përshkrimore**

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Për të organizuar, inkurajuar dhe mbështetur kërkimin shkencor në institucion është ngritur Zyra e Kërkimit Shkencor. Organizimi dhe menaxhimi i projekteve dhe kërkimit shkencor në KUB bëhet bazuar në rregulloren mbi projektet kërkimore shkencore. Kërkimi shkencor është pjesë e rëndësishme e misionit dhe objektivave të Institucionit. KUB ofron gjithashtu, mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari.

Kërkimi shkencor përqendrohet në pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit. KUB ka qenë vetë organizator i disa konferencave shkencore, ku pjesë e tyre kanë qenë jo vetëm anëtarët e personelit akademik por edhe studentët. Kështu, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze ka organizuar 5 Konferenca ndërkombëtare me pjesëmarrës nga vende të ndryshme, përveç konferencave, një element tjetër i kërkimit shkencor janë edhe botimet e ndryshme shkencore të realizuara në revistën shkencore të KUB si dhe në revista shkencore jashtë institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Lidhur me të dhënat për kërkimin shkencor, **shih Tabelën 16 në Aneks.**

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL është **91.**

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Nuk ka projekte kërkimore të fituara.

Numri i projekteve të zbatuara

Nuk ka projekte të zbatuara.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL është **24.**

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL është 166.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor është 32.

Numri i Çmimeve Kombëtare

Numri i Çmimeve Kombëtare është 1.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Pedagogët e KUB kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit KUB mbështet personelin akademik në formimin e tyre shkencor. Kjo vihet re në angazhimin e trupës akademike në konferenca, simpoziume të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli boton rregullisht punime shkencore në fushat e ndryshme, që ndihmojnë në ecjen përpara të zhvillimit shkencor.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Mësimdhënia e gjuhëve të huaja është një element të cilit KUB i kushton një rëndësi të veçantë duke pasur parasysh edhe praninë e studentëve të huaj në këtë institucion. Personeli akademik që ofron këtë shërbim duhet të ketë kryer studimet në atë gjuhë ose të zotërojë një certifikatë që vërteton njohuritë e avancuara të saj.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	Dokumentacioni i ofruar nga institucioni, si edhe intervistat e bëra me anëtarët e personelit akademik, nxorën në pah se personeli akademik dhe ai mësimor-shkencor i nënshtrohet trajnimeve të vazhdueshme dhe aktiviteteve të shumëllojshme shkencore, të cilat synojnë kualifikimin e duhur të vazhdueshëm profesional të stafit. <i>Megjithatë, duhet të rritet më tej angazhimi për të përfshirë personelin akademik në programe shkëmbimi</i>

	<i>apo projekte ndërkombëtare, në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies.</i>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Personeli akademik, pas kualifikimit në nivel vendor ose ndërkombëtar, dorëzon pranë KUB të gjithë dosjen ku përfshihen: njohuritë e reja të fituara, tekste të ndryshme shkencore ndër të cilat mund të gjenden edhe punime e tyre, kumtesat, artikujt etj.</p> <p>Nga ane e tij KUB ka një bazë të dhënash ku përfshihen të gjithë këto kualifikime të përfutuara në mënyrë që t'i përdorë në të ardhmen për trajnime të mëtejshme të personelit.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezulton se:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij. 2. KUB mbështet personelin akademik në formimin e tyre shkencor. 3. <i>Megjithatë, duhet të rritet më tej angazhimi për të përfshirë personelin akademik në programe shkëmbimi apo projekte ndërkombëtare, në funksion të kualifikimit të stafit akademik dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies.</i> 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar "Bedër" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e përbashkët të konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikat studentore me institucione të huaja arsimore. Aktualisht institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rreth 56 institucioneve, mes të cilave universitete, bashki, institucione publike dhe private. Strategjia për bashkëpunimet e mundshme pasqyrohet në strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit. Gjatë viteve akademike 2011-2018,

KUB ka organizuar rreth 26 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, anëtarët e personelit akademik si dhe studentët e KUB kanë marrë pjesë në veprimtari të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare është zero

Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj

Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj është 720 orë mësimore.

Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit

Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit është 5

Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL

Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL është 1

Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor

Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor është 5

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime është 38

KUB ka marrëveshje bashkëpunimi me 56 institucioneve, mes të cilave universitete, bashki, institucione publike, në shërbim të mbarëvajtjes së punës për realizimin e programeve të studimit. Nga viti 2011-2018 ka organizuar rreth 26 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të tjera. Lidhur me të dhënat për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, shih Tabelën 17 në Aneks.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

KUB ka marrëveshje me organizata profesionale, me biznesin me aktorë të tjerë për praktikant profesionale si dhe trajnime në fushën e mësimdhënies. Shih Aneksin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	

<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit me struktura të ndryshme të fushës së biznesit privat janë pozitive dhe ndihmojnë studentët ta shikojnë procesin e punës nga ana praktike.</p> <p>Njëkohësisht, duhet të përmendet fakti se ka një bashkëpunim të mirë edhe me fushat e sektorit publik.</p>
--	--

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Për mbarëvajtjen e programit gjatë takimeve në institucion, konstatoam se ka një prirje për bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. Kështu për shembull, shkëmbimi i mendimeve pasqyrohet edhe në mënyrën e hartimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të kurrikulës së programit, i cili propozohet nga Departamenti dhe pasi ka marrë miratimin e Dekanatit të Fakultetit, i dërgohet për miratim Senatit Akademik të Institucionit.</p> <p>Ndarja e detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analiza e vazhdueshme e punës së tyre është e parashikuar në Rregulloren e Organizimit Administrativ si dhe rregulloren mbi organizimin akademik. Ky fakt na u konfirmua edhe gjatë vizitës së kryer në institucion.</p>
--	--

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p>	<p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, ku fokusi kryesor është zhvillimi i shprehive praktike të studentëve dhe mundësive për punësimin e tyre.</p> <p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës për programin “MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze”.</p> <p>Në kuadër të programit “Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze” janë zhvilluar takime me përfaqësues nga Këshilli Britanik, seminare nga</p>
---	--

<p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>ekspertë për strategjitë e të mësuarit, përkthimin, redaktimin, workshop-i mbi zhvillimet e fundit mbi mësimdhënien e gjuhës angleze, etj. Përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve diksutohen në njësinë bazë.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar dhe të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, rezultton se:

1. Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj.
2. Bashkëpunimi mes personelit akademik të institucionit realizohet në bazë të detyrave dhe të drejtave të parashikuara në rregulloren dhe aktet e tjera të institucionit, si dhe në ndarjen e përgjegjësive mes organeve dhe autoriteteve të institucionit.
3. Institucioni ka organizuar veprimtari bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit në funksion të realizimit të programit të studimit.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Grupi i vlerësimit të Jashtëm, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se **institucioni ka përmbushur rekomandimet nga akreditimi i parë.**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Infrastrukturë e përshtatshme dhe pajisje didaktike moderne. Ambientet mësimore të KUB janë pajisura me kompjuter, projektor, smartboard, etj., të cilat i vijnë në ndihmë procesit të mësimdhënies e mësimnxënies në përgjithësi e atij të realizuar në gjuhë të huaj në veçanti.
2. Bibliotekë e pasur dhe me kushte të mira. Biblioteka tradicionale e institucionit kombinohet me platformat digjitale EBSCOHOST dhe JSTOR, në të cilat institucioni është abonuar dhe studentët e programit të studimit Master i shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze kanë akses të plotë në këto platforma. Si rrjedhojë, studentët por edhe stafi akademik kanë në dispozicion literaturë të pasur në shërbim të realizimit të programit të studimit.
3. Anëtarë të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit kanë përvoja ndërkombëtare në fushat përkatëse të mësimdhënies. Ndërkohë, janë angazhuar në këtë program studimi edhe pedagogë të huaj me përvojë në fushat e tyre të kualifikimit akademik.
4. Institucioni ka mundur administrimin online të të dhënave të studentëve e stafit akademik nëpërmjet sistemit të automatizimit BIS. Studentët, nëpërmjet aksesit individual në këtë sistem, mund të informohen lidhur me një sërë elementësh që lidhen me programin e studimit, si programet e lëndëve, orari, plani mësimor, etj. Gjithashtu, edhe anketimet periodike të studentëve realizohen online dhe duke ruajtur anonimat.

b. Pika të dobëta:

1. Institucioni nuk shfaq një nivel të lartë angazhimi në projekte ndërkombëtare, të cilat do t'i vinin në ndihmë si studentëve, ashtu edhe anëtarëve të personelit akademik. Mund të shfrytëzohen më mirë mundësitë e angazhimit në projekte të Bashkimit Europian, si Erasmus+, Horizon 2020, etj.
2. Nivel jo i lartë mobiliteti i studentëve dhe personelit akademik në universitete të ndryshme jashtë vendit, kryesisht në vende të Bashkimit Europian.

c. Mundësitë:

1. Përfshirje më të gjerë të studentëve dhe stafit në programet e shkëmbimit.
2. Nxitje dhe rritje e bashkëpunimit me institucione partnere brenda dhe jashtë vendit.
3. Studim më i formalizuar i tregut të punës në mënyrë periodike.

d. Pengesat:

1. Mungesa e ciklit të tretë të studimeve në të njëjtën fushë studimi ose në një fushë të përafërt.
2. Tregu i luhatshëm i punës dhe rënia e interesimit të studentëve për programet e studimit të kësaj natyre.

Rekomandime:

1. Studentët dhe personeli akademik në këtë program studimi duhet të jenë më të angazhuar në projekte ndërkombëtare, të cilat synojnë përfshirjen në projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor dhe mobiliteti.
2. Duhet të rritet mobiliteti i studentëve dhe personelit akademik.


**III.SUMARRY ANALYSIS ON MEETING THE FIRST ACCREDITATION
RECOMMENDATIONS**

After reviewing the documentation and visiting the institution, the evaluation team drew the conclusion that **the institution has met the first accreditation's recommendations.**

**IV.EER SUMMARY ANALYSIS ACCORDING TO THE SWOT METHOD (STRENGTHS,
WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).**

a. Strengths:

1. Appropriate infrastructure and modern didactic equipment. The teaching premises of BUC (Beder University College) are equipped with computers, projectors, smart boards, etc., which assist the teaching and learning process, especially those carried out in a foreign language.
2. A library rich in literature and with good conditions. The institution's traditional library is combined with the EBSCOHOST and JSTOR digital platforms, which the institution has subscribed to and to which the English Language and Literature students have full access. Hence, the students, as well as the academic staff, have access to rich literature which assists them in carrying out the study program.
3. The academic staff members, who are part of the study program, have international experience in the relevant teaching fields. Meanwhile, foreign lecturers with experience in their relevant academic qualification have also been engaged in this study program.



4. The institution has enabled the online administration of student and academic staff data through the BIS automation system. Individual access to this system enables students to be informed on a series of issues related to the study program, such as syllabuses, schedules, curricula, etc. Furthermore, the student's periodic surveys are performed online and remain anonymous.

b. Weaknesses:

1. The institution does not display a high level of engagement in international projects, which would be of help to students, as well as to academic staff members. The opportunities to engage in European Union projects, such as Erasmus +, Horizon 2020, etc., could have been used better.
2. Not a high level of student and academic staff mobility to universities abroad, especially to European Union countries.

c. Opportunities:

1. Wider engagement of students and staff in exchange programs.
2. Encouraging and increasing cooperation with partner institutions in and outside the country.
3. A more formalized market study on a periodical basis.

d. Threats:

1. Lack of the tertiary study cycle in the same or approximate field of study.
2. The changing job market and a decreasing interest of students in these kinds of study programs.

Recomandations:

1. Students and academic staff of this study program should be more engaged in international projects.
2. Student and academic staff mobility should be increased.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Leonard DANGLLI

Dr. Ergys BEZHANI

